



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1434/2 prot.

Datë 23.06.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Engineering Consulting Group” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF – 70983-05-30-2023 me objekt: “*Mbikqyrje punimesh me objekt, Rikonstruksion i shkollës + ndërtim palestre, Mjedë*”, me fond limit 1.443.718 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau Dejës.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Miki Consulting” SHPK
Lagjja Vasil Shanto, Rruga Vaso Kadia, godine nr 1/506,
Shkodër
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vau Dejës
Rruga “Qafa e Gurit” Vau Dejës
- Subjekte të Interesuara:** “Engineering Consulting Group” SHPK
Rruga “Arkitekt Kasemi”, pallati nr.22, te Brryli, Tiranë

Në datën 22.06.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3200, si dhe nr. protokollit 1434/2023 datë 22.06.2023 i operatorit ekonomik “Miki Consulting” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF – 70983-05-30-2023 me objekt: “*Mbikqyrje punimesh me objekt, Rikonstruksion i shkollës + ndërtim palestre, Mjedë*” me fond limit 1.443.718 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vau Dejës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Engineering Consulting Group” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriterin për të cilin, operatori ekonomik ankimues “Miki Consulting” SHPK, me anë të ankimit elektronik me nr. A/2023/3200, si dhe nr. protokoli 1434/2023 datë 22.06.2023, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Engineering Consulting Group” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime se vlera e ofruar dhe shpallur fituese, e operatorit ekonomik “Engineering Consulting Group, është nën vlerën minimale të lejuar, bazuar në VKM nr 354 datë 11.05.2016 dhe shtojcës 1 pjesë e këtij vendimi, në të cilën paraqitet metoda e llogaritjes së vlerës maksimale dhe minimale.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 23.06.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri